

ABSTRAKTI

Në paraqitjen e sjelljeve kriminale përvec faktorëve të jashtëm, ndikojnë edhe faktorët e brendshëm. Lidhmërinë e faktorëve të brendshëm me theks të vecantë çrregullimeve mendore me kriminalitetin e kanë studiuar kriminologë të shumtë. Sipas këtyre studimeve sjelljet dhe veprimet e njerëzve varen shumë nga struktura psikike e individit. Nëse kjo strukturë ka defekte dhe anomali, atëherë personaliteti i njeriut është i ndjeshëm ndaj ngacmimeve dhe ndikimeve që vijnë nga jashtë dhe si rrjedhojë mund të kryejë sjellje kriminale. Pjesëmarrja e kryesve të tillë në sjelljet kriminale në Kosovë nuk është studiuar mjaftueshëm, prandaj, qëllimi i këtij punimi është të kuptojë prezencën e tyre duke analizuar propozimet e prokurorive për shqiptimin e masave të trajtimit të detyrueshëm psikiatrik, vendimet e gjykatave ndaj këtyre kryesve si dhe veprat penale që ata i kanë kryer. Në këtë hulumtim është aplikuar metoda kualitative (deskriptive). Të dhënat janë mbledhur nga analizimi i legjislacionit për kryesit me çrregullime mentale në Kosovë, nga vendimet e Gjykatës Themelore në Prishtinë si dhe të dhënat statistikore e Njësitit për Shqyrtim të Performancë së Prokurorëve, e cila vepron në kuadër të Këshillit Prokurorial të Kosovës

Rezultatet e hulumtimit tregojnë se prokuroritë në Kosovë gjatë periudhës hulumtuese 2018-2023, kanë paraqitur 669 propozime për caktimin e masave të trajtimit të detyrueshëm psikiatrik të cilat janë të përcaktuara me Kodin Penal të Kosovës. Nga totali i këtyre kërkesave, gjykatat gjatë të njëjtës periudhë kanë shqiptuar 597 masa të trajtimit të detyrueshëm psikiatrik. Veprat penale të cilat i kanë kryer janë: sulmi, dhuna në familje, lëndim i lehtë trupor, kanosja, vjedhja e rëndë, vrasja e rëndë, asgjësim apo dëmtim i pasurisë, pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare, mashtrim, dhe vrasje në tentativë.

Fjalët kyçe: kriminalitet, çrregullime mentale, masa te trajtimit të detyrueshëm psikiatrik

